



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
S.H.A UJËSJELLËS –KANALIZIME SHKODËR
ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Nr. 1242 Prot.

Shkodër, më 13.09.2023

Vendim

Nr. 17 Datë 13/09/2023

PËR

PRISHJEN DHE SHPALLJEN NË LIKUIDIM TË SHOQËRISË UK SHKODËR S.H.A

Në mbështetje të nenit 135 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” ndryshuar; të Statutit të Shoqërisë UK Shkodër Sh.a; të Kreut II, të VKM Nr.302, datë 11.05.2022 “ Pë politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”; të nenit 7, pika 6, të Marrëveshjes për Krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër S.H.A, të lidhur midis Bashkive Shkodër, Malësi e Madhe, Vau Dejës, Fushë Arrëz dhe Pukë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë datë 19.01.2023, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër Nr. 38, date 26.07.2022 “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Shkodër në Subjektin me Kompetenc tw Pwrbashkwa, me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, Asambleja e Përgjithshme të Aksionarëve”,

Meqenëse shoqëria e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi në datën 31.08.2023 dhe kjo shoqëri nuk ka më të drejta të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar, nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj.

VENDOSI:

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj. Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.
2. Largimin nga detyra të administratorit Z. Gert Molla dhe emërimin e Z. Gert Molla si likuidator të shoqërisë.
3. Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TË UK SHKODËR S.H.A
KRYETAR I BASHKISË SHKODËR

BENET BECI

